



Asambleja

01.Nr.I

Deçan, dt.29.01.2021

### PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e I-rë të rregullt të Asamblesë Komunale , me dt.29.01.2021.

Në mbledhje ishin prezent:25 anëtarë të asamblesë, disa drejtor të drejtorive komunale, OJQ, mediat. Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2021,
3. Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2021,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Komitetit të Komuniteteve për vitin 2021,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Zyrës për komunitete dhe Kthim dhe Integritet Evropiane për vitin 2021,
6. Marrja e vendimit për Pëlqimin Mjedisorë për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisorë të PZHK-së,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Deçanit ,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Integritetit,
10. Shqyrtimi i Raportit të Përformancës për vitin 2019,
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit kundër korrupsionit,
12. Formimi i Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve/Zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën tonë,
13. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e I-rë të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent 25 asamblist (mungojnë pa arsye Erblina Tahiraj dhe Uran Tolaj).

Kryesuesi- e prezantoi rendin e punës të propozuar me ftesë.

Mon Selmonaj- ka thënë se mbledhjen e kaluar kam propozuar që të përkrahen financiarisht nga komuna të gjithë qytetarët e komunës së Deçanit të prekur nga Covid 19 si dhe familjarët e viktimave të Covid 19, dhe atë ditë jemi pajtuar që kjo çështje të vjen si pikë e rendit të ditës në këtë mbledhje, meqenëse nuk ka dalë si pikë e rendit të ditës kërkoj sqarim pse nuk ka dalë kjo kërkesë si pikë e veçantë e rendit të ditës.

Albesa Cacaj- thotë se në mbledhjen e dhjetorit i kemi nda 18.000 € për Ndërmarrjen Higjiena, për këtë kemi kërkuar raport nga Ndërmarrja për borxhet të cilat kanë thënë se i kanë në Sferkë të Gashit dhe borxhet në ATK, meqenëse raporti nuk ka ardhë kërkoj sqarim pse nuk ka ardhë sot, po ashtu kërkoj që raporti financiar i Ndërmarrjes Higjiena për vitin 2020 të vjen mbledhjen e radhës.

Mehmet Osaj- thot se kam kërkuar raport për 5 Llotet që i kemi dhënë në shfrytëzim afatgjatë, prapë kërkoj që Komuna të na bien raportin dhe të shohim se ku jemi me pagesat dhe barazimet financiare të 21% Komunë – Investitor, sepse objektet e ndërtuara po vërehet se janë lëshuar në përdorim.

Drejtori i Urbanizimit, Ramë Melaj- ka thënë se Investitori vetëm për një Llot (Lloti nr.1) i ka krye te gjitha obligimet ndaj Komunës dhe ka leje përdorimi, edhe një Llot (Lloti nr.3) investitori e ka bërë kërkesën për barazim dhe është në procedurë të barazimit me Komunën, ndërsa Llotet tjera nuk janë barazu me Komunën dhe nuk kanë leje përdorimi.

Florim Mataj- thot se pajtohem se si assemble duhet te na vjen ky raport, mirëpo ka thënë ai duke ju drejtuar Mehmetit, kur te kërkojsh raport duhet te fillojmë nga lokali yt Mehmet dhe te vazhdojmë me te gjitha te tjerat te kësaj natyre.

Kushtrim Loshaj- thot se pajtohem me kërkesën e Mehmetit e cila është përsëritë disa here këtu mirëpo që deri me tani nuk është plotësua, prandaj kërkoj qe te na vjen raporti deri ku kemi shku sa ju përket pronave te dhëna ne shfrytëzim afatgjate.

Ilir Ferizaj- thot se qe dy mbledhje kam kërkuar që të vjen drejtori i Ndërmarrjes Higjiena këtu për të na dhënë raport dhe prap kërkoj që raporti financiar të na vjen mbledhjen e radhës, për vitin 2020, po ashtu për këtë mbledhje kanë qenë të ftuar edhe disa persona tjerë përgjegjës për çështje tjera te caktuara por që nuk kane ardhë, pyes pse nuk kanë ardhë, ndërsa pyetje për drejtorin e Inspektionit është se a është ndëshkuar Ministri Zemaj për tubimin e mbajtur në Deçan i cili nuk i ka respektuar rregullat e parapara me ligj për parandalim kundër Covid 19.

Florim Mataj- thot se te gjitha kërkesat janë te qarta dhe të arsyeshme dhe kërkoj që të na vijne këtu sipas procedurave te parapara ligjore.

Kryesuesi- ka thënë se mbledhjen e radhës do te koordinohe mi me Ekzekutivin dhe te gjitha temat për te cilat kuni kërkuar raporte apo sqarime të çfar do natyre do ti kuni ne rend dite mbledhjen e radhës.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Izet Zenuni- ka sqaruar se kompania Higjiena prej mjeteve financiare te cilat e ka ndihmuar Komuna ne vlerë prej 18.000 € i ka paguar borxhet në deponinë ne Sferkë të Gashit dhe në ATK.

Drejtori i Inspektionit, Halil Tolaj- përgjigjet për pyetjen e Ilir Ferizaj se a është ndëshkuar ministri Zemaj i cili ka bere shkelje ligjore ne tubim ne Deçan, thotë se unë si drejtor i Inspektionit nuk kam njohuri ne vi zyrtare se ka ndodhe kjo mirëpo në shumë raste nuk po respektohet ligji ne tubimet elektorale.

Natyra Kuçi-pajtohet me vërejtjen e bere ma herët nga Iliri qe ministri i ka shkele rregullat , mirëpo përkundër kësaj nuk po ndëshkohet ka thënë ajo.

Drejtori, Halil Tolaj- thot se inspektori sanitar nuk ka qellu aty dhe nuk kemi flet paraqitje zyrtare për Ministrin.

Rendi i punës miratohet njëzëri.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

-Miratohet njëzëri pa vërejtje.

II. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2021.

Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj sqaron se në planin e prezantuar janë përfshi vetëm temat obligative, pastaj e ka hapë debatin ne Kuvend, mirëpo meqenëse nuk kishte debat për te, ai e qiti ne votim, anëtarët e kuvendit e miratuan njëzëri.

III. Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2021.

Propozimi për mbajtjen e mbledhjeve te kuvendit dhe te KPF-së miratohet njëzëri pa debat.

IV. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Komitetit të Komuniteteve për vitin 2021.

Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj ka shtuar se plani është mirë i përanditur, ne vazhdim e hapi debatin ne kuvend.

Mon Selmonaj- thot se kam kërkuar edhe ne KPF dhe po e përsëris këtë qe Komiteti te raporton ne Kuvend një here ne fund të vitit.

Kryesuesi- e qiti ne votim Planin e punës së Komitetit të Komuniteteve për vitin 2021, anëtarët e kuvendit e miratuan njëzëri atë, me ndryshimin qe Komiteti për punën e vet raporton ne Kuvend një here në fund të vitit .

Evropiane për vitin 2020.

Edhe ky plan miratohet njëzëri ne kuvend pa debat.

VI. Marrja e vendimit për Pëlqimin Mjedisorë për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisorë të PZHK-së.

Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj për sqarime fjalën ia kalon drejtorit te drejtorisë për Urbanizëm, i cili për te pranishmit sqaron se marrja e këtij vendimi është me rëndësi për shkak se është njëri prej dokumenteve i cili përfshihet në pjesën hyrëse te PZHK-së, pa të cilin nuk mund të vazhdojmë tutje në hartimin e PZHK-së, i paraparë me ligjin për Planifikim Hapësinor.

Milazim Mushkolaj- ka thënë se është mirë që ta shohim Planin Zhvillimor për të cilin i kemi mbajtur disa takime publike por nuk di deri ku kemi shkuar me hartimin e këtij plani.

Drejtori i Urbanizmit- thot se ne duhet me i krye procedurat ose hapat ligjorë për me ardhë deri te ky dokument, Plani te ju në kuvend do të vjen i përgaditur dhe ju pastaj i bini edhe vërejtjet dhe propozimet tuaja.

Erdogan Dautaj- ka thënë se Planin Zhvillimor tash është mirë që ta kemi si dokument të miratuar sepse jemi zhagitur pak prej fillimit te procedurave për hartimin e tij.

Shkelzen Hadergjonaj-pyet, leja për ndërtim a vlenë njëjtë për te gjitha lokacionet ne te gjitha zonat ku gjinden.

Drejtori- përgjigjet se ne e kemi Planin rregullues Zona e parë dhe Hartat zonale, aty përcaktohen këto gjana.

Florim Mataj- pyet, deri ku ka mbërri procedura për harta zonale me na sqaru.

Drejtori- përgjigjet se së pari miratohet PZHK e pastaj Harta Zonale.

Kryesuesi- tha se arsyesha mërinë e miratimit të këtij dokumenti e dha drejtori, pastaj e qiti në votim, anëtarët e kuvendit njëzëri e miratojnë atë.

VII. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Kryesuesi- e prezantoi projekt rregulloren pastaj ka sqaruar se te njëjtën e kemi pasë në diskutim publik por nuk kemi pasë pjesëmarrës, prandaj propozoj që nëse ju dëshironi mund ta shtyjme për mbledhjen tjetër dhe ta qesim edhe një here në diskutim publik.

Valdet Nuraj- ka thënë se rregullorja është paraqitë aq e mirë në letër sa që vetëm 40% e saj nëse zbatohet është mirë e lere ma krejt nëse zbatohet.

Kryesuesi- ka thënë se e drejta e fëmijëve garantohet me kushtetutë dhe me ligje andaj jam optimist se rregullorja do te gjenë zbatim të plotë.

Mustafë Selmanaj- ka thënë që pasi ka qenë në diskutim publik edhe tekstualisht është mjaftë e mirë propozoj që të miratohet sot.

Mon Selmonaj- pyet se a është neglizhenca e zyrtarëve apo mos interesimi i qytetarëve për pjesëmarrje në debat.

Kryesuesi- sqaron se njoftimi për debat është bërë në mënyrë të rregullt ashtu siç e parasheh ligji dhe procedurat, mirëpo qytetarët nuk kanë shprehë interesim për të marrë pjesë në debat.

Albesa Cacaj- thot se ne kemi miratuar shumë rregullore mirëpo te njëjtat nuk po zbatohen hiq.

Florim Mataj- thot se duhet ta cekim me emër se cila rregullore nuk po zbatohet dhe te flasim me emër konkret çdo njëri, e jo ashtu ne te përgjithshmen.

Kryesuesi- e qiti ne votim Projekt-Rregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës, anëtarët e kuvendit e miratuan atë me shumicë votash, rezultati votimit 19 për dhe 2 abstenime.

Drejtori i Drejtorisë për Administratë, Jashar Dobraj- ka sqaruar se kur i vjen anëtarit të kuvendit materiali për shqyrtim dy here ne kuvend ne dy seanca, po ashtu edhe proceduralisht janë zhvillu të gjitha procedurat e shpalljes së diskutimit publik është në rregull çdo gjë sepse kjo ndodhë mos me pasë të interesuar për pjesëmarrje në debat mirëpo çdo gjë është në rregull sa u përket procedurave me rregulloren në fjalë.

Illir Ferizaj-ka thënë se Komuna e Deçanit ka dalë dobët në performance , vetëm 4 komuna tjera janë ma ulet, kurse në komunat shqiptare e fundit ne transparence.

Drejtori Adinistrates- ka thënë se nuk është real raporti i performances.

Komunës së Deçanit.

Kryesuesi-e prezantoj rregulloren pastaj sqaroj se janë respektuar të gjitha procedurat ligjore, projekt rregullorja i është nënshtrua edhe diskutimit publik mirëpo nuk ka pasë propozim për ndryshim të rregullores, në vazhdim për sqarime fjalën ia ka dhënë përfaqësuesit te drejtorisë për Arsim, Besart Cacaj- i cili sqaron se si drejtori janë përkujdesë që rregullorja të jetë ne nivel, po ashtu ai thotë se nga debati i zhvilluar publik nuk ka propozim për ndryshim te rregullores.

Kryesuesi- e qiti ne votim, anëtarët e kuvendit e miratuan njëzëri projekt rregulloren për Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Deçanit.

IX. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit te Integritetit.

Kryesuesi- e prezantoj piken pastaj e hapi debatin rreth saj, mirëpo meqenëse nuk kishte diskutim rreth saj ai e qiti ne votim, Plani integritetit miratohet njëzëri .

X. Shqyrtimi i Raportit të Përformancës për vitin 2019.

Kryesuesi- e prezantoj këtë pikë pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë zyrtarit komunal- Koordinator i përformances komunale, Xhevat Lufaj, i cili ka dhënë sqarime te përgjithshme rreth këtij raporti.

Valdet Nuraj- ka thënë se përformanca për kulturë, rini , për sport, për shëndetësi, për kanalizim nuk është i saktë, menaxhimi i mbeturinave është në rregull, transporti publik –nuk kemi fare, parkingjet publike te prezantuara ku janë ato dhe në fund ka pyet se a e kini ngritë zanin për këtë raport i cili në shumë fusha nuk është i saktë.

Xhevat Lufaj- sqaron se raporti është plotësua sipas një formulari dhe fushave qe i përgatitë Ministria e pushtetit lokal, pastaj sipas atyre treguesve na dalin edhe këto rezultate.

Mon Selmonaj- propozon që të epen një here të gjitha vërejtjet e pastaj te epen sqarimet për to, në vazhdim në lidhje me raportin ai ka thënë se për secilën fushë është dashtë të vijnë 2-3 tregues, te treguesi për ujë te pijshëm si ka dalë 100% kurse nuk kemi ujë të pijshëm non stop, te mbrojtja e ambientit 93.3 % ju ka dale shumë, te kultura nuk është real, zhvillimi ekonomik 77% ku janë ata tregues qe na kanë qite ne këtë përqindje, poashtu te punësimi vërejtje, mirëpo vërejtjen kryesore ka thënë ai e kam te kanalizimi 45.6 % gjë që nuk qëndron, te shëndetësia aq ulet nuk është reale. Moni falënderon publikisht drejtorin e QKMF-se, z.Selman Berisha, për pritjen qe i ka bere ne QKMF dhe për sqarimet dhe shënimet qe i ka dhënë për çdo pyetje dhe çështje te ngritur aty.

Xhevat Lufaj-sqaron se shënimet i qesim sipas kritereve qe kërkohen ne formularët qe na dërgohen neve me pyetje konkrete dhe pastaj ne kemi dale me këto përqindje.

Milazim Mushkolaj- thotë se QKMF ka qene shumë e angazhuar sidomos gjatë kohës se pandemisë, te cilët kane punuar edhe natën dhe me dale këto te dhëna është e çuditshme.

Florim Mataj- për kanalizim a është pyetja sa janë te kyçur ne kanalizim dhe te kanë dalë këto shifra apo si është, te kujdesi primar shëndetësor pyes a është bere matja se a kanë te gjithë qytetarët shërbim shëndetësor apo si janë nxjerre këto shifra.

Xhevat Lufaj- sqaron si behën pyetjet ne formular te cilët i qesin pastaj këto shifra.

Drejtori i Shërbimeve publike, Izet Zenuni- ka thënë se ne i mirëpresim kritikën por vetëm mi krahasu raportin tone me Komunën e Pejës apo me ndonjë Komunë tjetër do ta shihni se ne jemi ne pozitë shumë ma te volitshme.

Ajne Iberhysaj, anëtare e grupit punues te përformances - sqaron se ne na vjen nga MAPL formulari i përanditur me pyetje konkrete dhe ne i qesim te dhënat aty kurse kalkulimin e bene vet sistemi pastaj, treguesit vijnë nga niveli qendror ne i qesim te dhënat, sipas këtij raporti Komuna e Deçanit e ka vendin e 15-te, ne vazhdim ajo ka dhënë sqarime te hollësishme për te gjitha çështjet e ngritura.

Drejtori i QKMF-se , Selmon Berisha- sqaron te treguesi te metrat katror ne QKMF është gabim, laboratorin e kemi por është vetëm një dhe për këtë kemi dale keq, mirëpo laboratorin është shumë funksional dhe i kryen 97 % te shërbimeve, për te hyrat nuk ka faj shërbimi, ai e ka përmbyllë sqarimin e tij duke thënë se këtu ka gabime teknike sepse asnjë dikaster nuk punon ma mire se

vitit 2018.

Mon Selmonaj- pyet , këto gabime teknike a kanë rrjedhe nga punëtorët e QKMF apo diku tjetër ne komunë.

Illir Ferizaj- pyet, ne repartin e maternitetit për lindje ne QKMF a duhet mi pasë transfuzionin e gjakut.

Drejtori QKMF-se përgjigjet, jo, nuk është i paraparë.

Kryesuesi, Dr.Haki Shehaj- sqaron sipas mënyrës se organizimit dhe funksionimit te QKMF-se si duhet te bëhen shumë shërbime aty ndërsa për transfuzion te gjakut te lindjet thotë se nuk parashihet ne QKMF kjo gjë.

Kryesuesi- ka thënë se u bene mjaft pyetje dhe për te njëjtat u dhanë sqarime të mjaftueshme prandaj e mbyllim si teme.

XI. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit kundër korrupsionit.

Miratohet njëzëri pa debat.

XII.Formimi i Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve/Zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën tonë.

Kryesuesi- e prezanton kërkesën e drejtorisë për Arsim, për te njëjtën Besart Cacaj, zyrtar i drejtorisë për arsim, ne mungese te drejtorit për arsim, ka dhënë sqarime.

Formohet Komisioni për përzgjedhjen e Drejtorëve/Zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën tonë, sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2020, ne këtë përbërje: Xhevat Bozhdaraj nga DKA-Udhëheqës i Sektorit të Arsimit, dhe 2. Burim Bruqi-Kryetar i Këshillit të prindërve në nivel Komune.Vendimi për formim te komisionit merret njëzëri.

XIII.Të ndryshme.

1.Me rekomandim të KPF-së shqyrtohet Kërkesa e punëtorëve shëndetësorë(mjekë dhe infermier) te cilët kane punuar gjate kohës se pandemisë covid 19 dhe nuk janë përfshi ne pakon qeveritare sepse nuk janë ne listë të pagave sepse janë të punësuar me kontratë me kushte të veçanta. Pagesa kërkohet të bëhet për muajtë Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020, sipas listës së prezantuar nga QKMF dhe datave të punësimit, mirëpo meqenëse vlera mbi 5000€ kërkon që vendimi të merret në Kuvend, KPF i rekomandojnë Kuvendit për miratimin e kësaj kërkesë, llogaritja bëhet sipas listës se mjekëve dhe infermierëve, sipas përlllogaritjes shuma e mjetëve të kërkuara është 7550 €.

Illir Ferizaj- thot se është e drejte e stafit mjekësorë për tu paguar për angazhimin e tyre gjate kohës se pandemisë, kërkesa është e arsyeshme dhe e përkrahi.

Kryesuesi e qiti ne votim, kërkesa miratohet njëzëri nga asamblistët ( në momentin e votimit në sallë janë 16 asamblist).Mjetet financiare, për zbatimin e këtij vendimi ndahen nga mjetet buxhetore të-Kujdesi Primar Shëndetësor-kodi buxhetor 73900, në kategorinë Mallra&Shërbime.

Albesa Cacaj-ka ngrite çështjen e nxënies së trotuareve gjate gjithë kohës me automjete të parkuara pastaj ka pyet se a kini bashkëpunua me policinë për këtë gjë.

Drejtori Sherbimeve Publike, Izet Zenuni- sqaron se policia ka një plan operativ për hapësirat publike , komuna vetëm shenjat i qet por nuk jemi kompetent për këtë gjë.

Milazim Mushkolaj- pyet, makinat e komunës qe ja kini dhënë policisë çka është bere me to.

Izet Zenuni- përgjigjet se pas kryerjes se punës i kanë kthy.

2.Kerkesa për shndërrimin e tokës bujqësore ne tokë ndërtimore.

Kryesuesi-e ka prezentu një kërkesë te drejtorisë për BPZHR për ndërrimin e tokës bujqësore ne toke ndërtimore.

Bajram Çeku, zyrtar i drejtorisë për BPZHR- sqaron se kërkesa e pronarit privat nga fshati Isniq është ne harmoni me ligjin dhe me udhëzimin Administrativ, behet fjalë për 870 m<sup>2</sup> tokë bujqësore.

Milazim Mushkolaj- thotë se ne vetëm e bëjmë ndërrimin e tokës nga toka bujqësore ne tokë ndërtimore ndërsa procedurat tjera i kryen vet pronari.

të caktuar.

Drejtori Urbanizmit, Ramë Melaj-sqaron se toka është kategori e pestë dhe sipas ligjit lejohet ndërrimi i destinimit nga Komuna, investitori nga fshati Isnij i cili planifikon te ndërton një fabrikë ne token e vet është shumë serioz, po ashtu nuk bien ndesh me Planin Zhvillimor.

Illir Ferizaj- pyet a kemi pasë raste tjera te ndërrimit te destinimit te tokës.

Drejtori Administratës, Jashar Dobraj- përgjigjet, po, kemi pasur.

Mon Selmonaj- thot se unë kam pak vërejte se nuk janë zhvillu procedurat paraprake te shqyrtimit dhe te miratimit te kërkesës, kërkesa nuk ka kalu fare për shqyrtim ne KPF, vetëm tash kur u prezentu këtu, edhe kryetari na pat pru një biznesmen këtu për ndërtim te një spitali dhe shtëpie për pleq pa kaluar fare asnjë procedure, unë i lus te gjithë kolegët këtu që të na përkrahin ne respektimin e procedurave.

Drejtori Urbanizmit- thot se ki te drejte ti Mon, por ky është rast specifik sepse pala e ka afatin e caktuar dhe ka me shku ne boten e jashtme ku punon dhe krejt çka patëm mundësi te bëjmë ta qesim ne këtë mbledhje për shqyrtim, mirëpo investitori është shumë serioz.

Mehmet Osaj- thot se pajtohem me Monin për respektim te procedurave sepse duhet te respektohen procedurat për shqyrtim të çdo kërkesë në Kuvend.

Kryesuesi-e qiti ne votim kërkesën e drejtorisë për BPZHR për ndërrim te destinimit te tokës bujqësore ne toke ndërtimore, anëtarët e Asamblesë e miratuan njëzëri, (20 asamblist ishin ne salle prezent).


Valdet Nuraj- thotë se ne kuvend e kemi miratu pajisjen me makina te reja para tri viteve për nevoja te komunës se Deçanit, pyes pse janë kthye një pjesë e tyre, a janë pagu apo i kemi borgj pa pagu, konkret pse është ndërpre kontrata.

-Mbledhjen e radhës Ekzekutivi përgjigjet për këtë pyetje ne kuvend.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse:

Dyke Lllolluni



Verifikon procesverbalin:

Kryesuesi i Kuvendit:  
Haki Shehaj

